

VENDIM
Nr. 80, datë 18.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E
TRANSAKSIONEVE BANKARE NË RRUGË ELEKTRONIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.3.2005, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- a) Neni 5, shfuqizohet.
2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko